

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSOR PRIVAT
ZYRA PËRMBARIMORE KURMAKU

Adresa: Lagja "5 Maji", rruga "28 Nëntori", ndërtesa 39, hyrja 13,3001, kati 2, Elbasan. Nr.Cel: 0673115333



URDHER

Nr. 37 Aktit, datë 18.11.2019

"PER VENDOSJEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE"

Drejtuar : Qendrës Kombëtare të Biznesit Tiranë
Adresa : Blv. « Zhan D'Ark », prona Nr.33, shtëpia Ushtarake, Tiranë

Për dijeni:
Subjekti "L&B FRUITS 2006" shpk
Adresa: Lushnje

Në Elbasan, sot më datë 18.11.2019.

Unë Kastriot Isuf Kurmaku Përmbarues Gjyqësor Privat, regjistruar në regjistrin kombëtar të Përmbaruesve Gjyqësor Privat, pranë Ministrisë së Drejtësisë Tiranë, sipas çertifikatës nr.38, datë 10.09.2010 "Për ushtrimin e veprimtarisë si Përmbarues Gjyqësor Privat",

KONSTATOJ se:

ë datë 05.11.2019 është regjistruar pranë kësaj zyre kërkesa e kreditorit subjektit "Albplast" shpk, përfaqësuar me prokurë nr. 1358 rep, 576/5 kol, datë 10.10.2019 nga z. Agron Muça. Në bazë të saj kërkohet zbatimi i "Urdhrit të ekzekutimit" nr. 502, datë 17.10.2019 të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Lushnje, për ekzekutimin e "Titullit ekzekutiv", Faturave Tatimore Shitje, me palë:

-Kreditor : Subjekti "Albplast" shpk, me Nipt K73026210L

-Debitor : Subjekti "L&B FRUITS 2006" shpk, me Nipt L64613401C

-Objekti : Shlyerje detyrimi (*likujdim faturash tatimore*),

Në kushtet kur debitori nuk e ka shlyer detyrimin sipas njoftimit të përmbaruesit gjyqësor, në zbatim të "Urdhrit të ekzekutimit" nr. 502, datë 17.10.2019 të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Lushnje, për ekzekutimin e "Titullit ekzekutiv", Faturave Tatimore Shitje, duhet të kryhet bllokimi i aksioneve dhe kapitalit të subjektit debitorë.

Sa sipër,

URDHEROJME:


1. Vendosjen e masës së sekuestros konservative mbi kapitalin e Subjektit "L&B FRUITS 2006" shpk, me Nipt L64613401C, deri në shlyerjen e plotë të detyrimit prej 2,282,064 (*dymilion e dyqindetëdhjetëedymijë e gjastëdhjetëekatër*) lekë, pra deri në një urdhër të dytë të Përmbaruesit Gjyqësor.
2. Për veprimet apo mosveprimet tuaja na vini në dijeni shkresërisht brënda afatit ligjor.
3. Personat që bëhen pengesë do të përgjigjen sipas dispozitave të K. Penal dhe nenit 598 e në vijim të K.Pr.Civile.
4. Ky urdhër u njoftohet palëve të cilët në rast kundërshtimi, kanë të drejtën e ankimit në Gjykatë brënda 5 (*pesë*) ditëve nga marrja dijeni.

Bashkëlidhur një kopje të "Urdhrit të Ekzekutimit" nr. 502, datë 17.10.2019 të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Lushnje

PERMBARUESI GJYQESOR

Kastriot KURMAKU





REPubLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
LUSHNJË

Nr. 502 Regjistri themeltar
Datë Regjistrimi 09.10.2019

Nr. 502 Vendimi
Datë Vendimi 17.10.2019

V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS

“Për lëshimin e Urdhrit të Ekzekutimit”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnje, e perbere prej :

GJYQTARE: LORENA ÇABEJ

Me cilesinë e gjyqtarit të vetëm, në dhomë këshillimi pa praninë e palëve, sot në datë 17.10.2019, mori në shqyrtim kërkesën civile me Nr. 502 Regj.Them, që i përket:

KERKUES: Shoqëria “Albpast” shpk, me Nr.NUIS K730262101, me adresë Bradashesh, ish Ndërmarrja e Seleksionimit Metal, Elbasan, me administrator Z. Yusuf Gokdemir, i datëlindjes 23.06.1981 lindur në Gorele dhe banues në Elbasan.

OBJEKTI: Lëshimin e Urdhrit të Ekzekutimit për Fatura Tatimore Shitje:

- Faturë Nr Serie 34375960 datë 01.11.2016 (pjesërisht me vlerën 9.090 Lek)
- Faturë Nr Serie 34375965 datë 03.11.2016.
- Faturë Nr Serie 34375995 datë 09.11.2016.
- Faturë Nr Serie 49033331 datë 26.11.2017.
- Faturë Nr Serie 49033332 datë 27.11.2017
- Faturë Nr Serie 49033333 datë 27.11.2017
- Faturë Nr Serie 49033334 datë 28.11.2017
- Faturë Nr Serie 49033339 datë 29.11.2017
- Faturë Nr Serie 49033341 datë 30.11.2017
- Faturë Nr Serie 49033349 datë 02.12.2017
- Faturë Nr Serie 49033350 datë 04.12.2017
- Faturë Nr Serie 49033353 datë 07.12.2017
- Faturë Nr Serie 74097384 datë 30.05.2019

- Faturë Nr Serie 74097382 datë 29.05.2019
- Faturë Nr Serie 74097358 datë 24.05.2019
- Faturë Nr Serie 74097449 datë 22.05.2019
- Faturë Nr Serie 74097442 datë 21.05.2019
- Faturë Nr Serie 74097397 datë 03.06.2019

BAZA LIGJORE: Neni 510 i Kodit të Procedurës Civile së Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, ligji nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare”.

GJYKATA:

- Si shqyrtoi kërkesën e palës kërkuese dhe aktet shkresore të depozituara, për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për faturat tatimore të shitjes të sipërcituara, në përputhje me dispozitat ligjore të zbatueshme, neni 510 e vijues i Kodit të Procedurës Civile,

VEREN

Se kërkuesi shoqëria Albplast shpk, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me kërkesë për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për faturat tatimore të shitjes sipas objektit të kërkesës për një detyrim në total në shumën 2,823.900 (*dy milion e tetëqind e njëzetë e tre mijë e nëntëqind*) Lek, detyrim në ngarkim të debitorit shoqëria “L&B FRUITS 2006” shpk me NUIS L64613401C me adresë Fier, Lushnjë, Rruga e Fierit km 2, magazinë 1 katëshe, Nr. 3.

Me vendimin nr. 404 datë 26.07.2019 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka vendosur shpalljen e moskompetencës tokësore në lidhje me këtë kërkesë dhe ia ka dërguar çështjen për shqyrtim Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

Nga shqyrtimi i kërkesës në dhomë këshillimi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, rezulton se kërkuesi shoqëria Albplast shpk ndodhet në një marrëdhënie juridike detyrimi me shoqërinë “L&B FRUITS 2006” shpk. Në kuadër të përmbushjes së të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga kjo marrëdhënie juridike, shoqëria Albplast shpk ka kryer furnizimin me mallin arka plastike në cilësinë e shitësit për shoqërinë “L&B FRUITS 2006” shpk në cilësinë e blerësit. Gjatë vazhdimit të marrëdhënies kontraktore midis palëve, furnizuesi shoqëria Albplast shpk ka lëshuar faturat tatimore të shitjes sipas objektit të mosiperm.

Kërkuesi pretendon se debitori nuk ka përmbushur detyrimin që buron nga faturat tatimore të shitjes. Në këto kushte, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për faturat tatimore të shitjes, të cituara në objektin e kërkesës. Gjykata e mon se shoqëria tregtare Albplast shpk legjitimohet për të kërkuar lëshimin e urdhrit për ekzekutimin titullit ekzekutiv për detyrimin që përmbajnë 18 faturat e mësipërme sepse me cilësinë e palës kreditore të veprimit juridik tregtar ka përmbushur detyrimin pa marrë kundërpagësen nga pala debitore.

Nga tërësia e provave të verifikuara në dhomë këshillimi, Gjykata vlerëson se kërkesa e paraqitur nga kërkuesi është e mbështetur në prova dhe në ligj dhe si e tillë duhet pranuar.

urdhri i ekzekutimit per aktin qe e mbart këtë detyrim, e që në rastin konkret është fatura tatimore e shitjes, pavarësisht se ligji i posaçëm nuk e parashikon shprehimisht që "titull ekzekutiv është faturë tatimore e shitjes", por parashikon detyrimin monetar te lindur, te pajundërshtuar, por të papërbushur në kohë si titull ekzekutiv.

Nga ana tjetër, detyrimi i përcaktuar në faturat tatimore të shitjes për të cilat kërkohet lëshimi i urdhrit të ekzekutimit, në rastin konkret:

- a) Ka lindur pas hyrjes në fuqi të Nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare" (neni 15 i Ligjit);
- b) Është i përcaktuar saktë;
- c) I kërkueshëm, pasi edhe pas kalimit te afatit (neni 463 i K.Civil), detyrimi i përcaktuar në faturë nuk rezulton të jetë përbushur;
- d) I njohur prej të dy palëve të veprimit juridik tregtar, pasi faturat tatimore janë nënshkruar edhe nga shitësi edhe nga blerësi.

Bazuar në analizën ligjore dhe faktike të mësipërme, gjykata çmon se faturat tatimore të shitjes të mëposhtme:

- Faturë Nr Serie 34375960 datë 01.11.2016 (pjesërisht për vlerën 9.090 Lek)
- Faturë Nr Serie 34375965 datë 03.11.2016.
- Faturë Nr Serie 34375995 datë 09.11.2016.
- Faturë Nr Serie 49033331 datë 26.11.2017.
- Faturë Nr Serie 49033332 datë 27.11.2017
- Faturë Nr Serie 49033333 datë 27.11.2017
- Faturë Nr Serie 49033334 datë 28.11.2017
- Faturë Nr Serie 49033339 datë 29.11.2017
- Faturë Nr Serie 49033341 datë 30.11.2017
- Faturë Nr Serie 49033349 datë 02.12.2017
- Faturë Nr Serie 49033350 datë 04.12.2017
- Faturë Nr Serie 49033353 datë 07.12.2017
- Faturë Nr Serie 74097384 datë 30.05.2019
- Faturë Nr Serie 74097382 datë 29.05.2019
- Faturë Nr Serie 74097358 datë 24.05.2019
- Faturë Nr Serie 74097449 datë 22.05.2019
- Faturë Nr Serie 74097442 datë 21.05.2019
- Faturë Nr Serie 74097397 datë 03.06.2019

të lëshuara nga pala kërkuese shoqëria tregtare Albplast shpk për blerësin shoqërinë tregtare "L&B FRUITS 2006" shpk objekt kërkese përbëjnë titull ekzekutiv.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata mbështetur në nenet 510, 511 të K.Pr.Civile,

VENDOSI:

Bazuar në nenin 511/ç të K.Pr.Civile, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë ka kompetencën lëndore e tokësore për lëshimin e këtij urdhri, si gjykata e vendit ku detyrimet që përmban titulli ekzekutiv do të përmbushen, pasi shoqëria tregtare pale debitore e kësaj marrëdhënieje juridike ka qendrën e ushtrimit të veprimtarisë tregtare në Lushnjë.

Shoqëritë tregtare Albplast shpk dhe "L&B FRUITS 2006" shpk të krijuara sipas ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar përbëjnë "sipërmarrje tregtare", në kuptim të nenit 3 pika 3 të Ligjit Nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare". Sipas përkufizimeve të përcaktuara në këtë ligj "Veprimi juridik tregtar" është kontrata apo çdo veprim tjetër juridik, i kryer ndërmjet ndërmarrjeve tregtare ose ndërmjet ndërmarrjeve tregtare nga njëra anë, dhe autoriteteve publike, nga ana tjetër, të cilat çojnë në lëvrimin e mallrave ose realizimin e shërbimeve kundrejt një kundërpagese." Në kushtet kur secila prej shoqërive tregtare si më sipër, përbën një sipërmarrje tregtare në kuptim të ligjit, veprimi juridik i kryer mes tyre është veprim juridik tregtar. Pala kërkuese ka ofruar shërbimin kundrejt kundërpaguesës së përcaktuar saktësisht në faturën tatimore, të lëshuar sipas Ligjit "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", nenet 49-51 të tij.

Detyrimi monetar i parashikuar në këto fatura tatimore në kuptim të nenit 16 të ligjit nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare", përbën titull ekzekutiv vetëm nëse detyrimi ka lindur nga veprimet juridike tregtare, të cilat nuk janë shlyer brenda afatit të pagesës përkatëse, sipas këtij ligji, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 485 i Kodit Civil. Këto detyrime përbëjnë titull ekzekutiv dhe vihen në ekzekutim nga përmbaruesi gjyqësor, pavarësisht vlerës, kur: a) kreditori ka lëvruar mallrat apo kryer shërbimet sipas kontratës dhe ligjit; dhe b) debitori nuk e ka kundërshtuar detyrimin. Në këto raste, detyrimi së bashku me kamatëvonesat dhe me shpërblimin për shpenzimet për rikthimin e shumës mund të vihen në ekzekutim të detyrueshëm, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile, çka nënkupton lëshimin e një urdhri ekzekutivi nga gjykata.

Nga ana tjetër K.Pr.Civile në nenin 510/e parashikon: "Janë tituj ekzekutivë aktet e tjera që sipas ligjeve të veçanta quhen tituj ekzekutive dhe ngarkohet zyra e përmbarimit për ekzekutimin e tyre". Sa më sipër, në zbatim të nenit 510 të K.Pr.Civile, titulli ekzekutiv është vetëm akti, forma e materializuar e mbajtjes së detyrimit (vendim gjyqësor, arbitrazhi, faturë tatimore e shitjes së energjisë elektrike, akt për dhenien e kredive nga institucionet financiare jobankare, akt për dhenien e kredive bankare...etj) dhe jo vetë detyrimi i përcaktuar në këto akte. Në ndryshim nga ky parashikim i K.Pr.Civile, Ligji Nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare", konsideron titull ekzekutiv që ekzekutohet nga përmbarimi sipas dispozitave të K.Pr.Civile, vetë detyrimin që lind nga një veprim juridik tregtar.

Qëllimi i ligjit nr.48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare", ka qenë veç të tjerash edhe sigurimi i funksionimit të duhur të tregut të brendshëm, duke nxitur aftësinë konkurruese të ndërmarrjeve tregtare dhe, në veçanti, të ndërmarrjeve të vogla e të mesme. Nisur nga ky qëllim, parashikimi në ligj i detyrimit monetar të lindur nga veprimet juridike tregtare, kur njëra pale e ka lëvruar mallin apo ka kryer shërbimin dhe pala tjetër nuk e ka kundërshtuar detyrimin, si titull ekzekutiv, në interpretim edhe të nenit 510/e të K.Pr.Civile, duhet kuptuar i tillë që në të gjitha rastet për ekzekutimin e tij duhet lëshuar

1. Pranimin e kërkesës.
2. Lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për vënien në ekzekutim të detyrueshëm të detyrimit, që ka shoqëria tregtare "L&B FRUITS 2006" shpk kundrejt palës kërkuese shoqërisë tregtare Albplast shpk, sipas faturave tatimore të shitjes të mëposhtme:
 - Faturë Nr Serie 34375960 datë 01.11.2016 (pjesërisht për vlerën 9.090 Lek)
 - Faturë Nr Serie 34375965 datë 03.11.2016.
 - Faturë Nr Serie 34375995 datë 09.11.2016.
 - Faturë Nr Serie 49033331 datë 26.11.2017.
 - Faturë Nr Serie 49033332 datë 27.11.2017
 - Faturë Nr Serie 49033333 datë 27.11.2017
 - Faturë Nr Serie 49033334 datë 28.11.2017
 - Faturë Nr Serie 49033339 datë 29.11.2017
 - Faturë Nr Serie 49033341 datë 30.11.2017
 - Faturë Nr Serie 49033349 datë 02.12.2017
 - Faturë Nr Serie 49033350 datë 04.12.2017
 - Faturë Nr Serie 49033353 datë 07.12.2017
 - Faturë Nr Serie 74097384 datë 30.05.2019
 - Faturë Nr Serie 74097382 datë 29.05.2019
 - Faturë Nr Serie 74097358 datë 24.05.2019
 - Faturë Nr Serie 74097449 datë 22.05.2019
 - Faturë Nr Serie 74097442 datë 21.05.2019
 - Faturë Nr Serie 74097397 datë 03.06.2019
3. Ngarkohen shërbimet përmbarrimore gjyqësore, shtetërore ose private për zbatimin e këtij urdhri ekzekutimi.
4. Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.
5. Ky vendim lëshohet vetëm në një kopje dhe si i tillë ka vlerë.
6. U shpall sot në Lushnjë, më 17.10.2019.

**GJYQTARE
LORENA CABEJ**

